

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Universiteti	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
Njësia akademike	Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës
Programi	Inxhinieri industriale me informatikë
Titulli i lëndës	Praktikë (Internship)
Niveli	Bachelor
Statusi lëndës	Obligative
Viti i studimeve	III, Semestri VI
Numri i orëve në javë	5
Vlera në kredi – ECTS	5
Koha / lokacioni	-
Mësimdhënësi i lëndës	
Detajet kontaktuese	_____
Përshkrimi i lëndës	<i>Kjo lëndë do t'u mundësojë studentëve të përfshihen në punë praktike në një mjedis të industrisë dhe të merren me probleme reale të inxhinierisë. Me qëllim që të njihen me problemet konkrete në thirrjen e ardhshme, studentët udhëzohen të kalojnë një numër të orëve të parashikuara të punës në Kompani dhe Institucione në mjedise më të ngushta dhe më të hapura. Studentët marrin detyra specifike në vendet e tyre të punës, kryerja e të cilave tregon nivelin e deriatëhershëm të përvetësimit të njohurive të parapara në programin e studimit. Detyrat që studentët marrin janë të lidhura drejtpërdrejt me detyrat që duhet të bëjnë pas diplomimit. Studentëve u caktohet një mentor nga një Kompani – Institucion që monitoron dhe vlerëson kryerjen e detyrave. Gjatë praktikës profesionale mbahet Ditari¹ në të cilin futen të gjitha aktivitetet të cilat iu janë besuar studentit.</i>
Qëllimet e lëndës	<i>Praktika përfundimtare profesionale është një pjesë integrale e procesit të trajnimit, e cili ka për qëllim forcimin e njohurive teorike të studentëve dhe marrjen e aftësive praktike në fushën e tyre të zgjedhur të specializimit.</i>
Rezultatet e pritura të nxënies	<i>Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lende, studentët duhet të jenë në gjendje të:</i> • njohin parimet ligjore të punës, standardet ndërkombëtare të punës • aplikojnë teorinë në praktikë në një mjedis të vërtetë pune

¹Udhëzimi për praktikën përfundimtare profesionale epet në vazhdim!

	punojnë në mënyrë të pavarur dhe si anëtar i ekipit në detyrat e caktuara në kompani.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Mësim (Ligjërata dhe ushtrime)	3	4	12
Punë praktike	4	24	96
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Kolokiume, seminare			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	4	16
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3		3
Projektet, prezantimet , etj.	4		4
Totali			126
Metodologjia e mësimdhënies	Intership, kryhet nga studenti në semestrin VI-të nën drejtimin e një mësimdhënësi – praktikues të praktikës profesionale. Enkas për student janë përgatitur Modele në programin Word mbi bazën e të cilëve ata do të përmbyllin Praktikën përfundimtare profesionale (Ditarin e praktikës) në Kompani, Ndërmarrje, Institute, Fabrika apo Servise të licencuara, në rend të parë me ato të cilët UShAF ka Marrëveshje bashkëpunimi.		
Parakushtet	Nuk ka parakushte për të filluar të mësuarit e Intership-it. Megjithatë, rekomandohet që studentë të kenë njohuri bazike të programimit.		

Metodat e vlerësimit	Studenti e kalon provimin nga Intership, bazuar në Ditarin e shkruar të praktikës profesionale. Provimi epet me gojë, dhe sukse si i praktikës përfundimtare profesionale vlerësohet me notë, nga 6 -10. Studenti, ditari i të cilit nuk pranohet, është i detyruar të përsërisë Praktikën përfundimtare profesionale. Vendimi për notën përfundimtare merret në mbështetje të pikëve të fituara nga Intership (Ditari i praktikës), vlerësuar nga mbikëqyrësi dhe mësime dhënësi, Vlerësimi: 91-100 pikë – vlerësohet me notë 10 (dhjetë) 81-90 pikë – vlerësohet me notë 9 (nëntë) 71-80 pikë – vlerësohet me notë 8 (tetë) 61-70 pikë – vlerësohet me notë 7 (shtatë) 51-60 pikë – vlerësohet me notë 6 (gjashtë) 0-50 pikë – Studenti ri-përsëritë në provim.
Raporti i teorisë dhe praktikës	30% teori dhe 70% punë praktike në Kompani, Ndërmarrje, Institute, Fabrika apo Servise, në Kompani, Ndërmarrje, Institute, Fabrika apo Servise, në rend të parë me ato të cilët UShAF ka Marrëveshje bashkëpunimi dhe që mundësojnë realizimin e Praktikës profesionale.
Literatura	
Literatura bazë	1. Manuali i punës praktike 2. Materiale të ofruara nga mësime dhënësi
Literatura shtesë	1. Prof.Musli Bajraktari University of Prishtina (Authorized Lectures), 2011 2. Basic Law on Protection at Work "Official Gazette of the Republic of Kosovo" / no. June 22/14, 2013, PrisLaw no. 04 / I-161 For safety and health at work Assembly of Republic of Kosovo;
Plani i detajuar i mësimit	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Njohja me strukturat e organizimit të punëve menaxheriale dhe prodhuese në fabrikë..
Java e dytë	Njohja me byronë konstruktive dhe përgatitjen e projekteve
Java e tretë	Te dizajnohet dhe te programohet detali punues
Java e katërt	Të njihet me programet prodhuese dhe asortimentin e prodhimit.
Java e pestë	Njohje me përgatitje të dokumentacionit tekniko - teknologjik.
Java e gjashtë	Të realizojnë procesin prodhues të detalit të zgjedhur
Java e shtatë	Kontrollimi dhe matja e detaleve te realizuara sipas standardeve
Java e tetë	Të njihen me përgatitjen e punëve (planeve dhe programeve punuese).

Java e nëntë	<i>Analiza e te gjitha makinave ne repart (Stabilimentet complete të prodhimit, impiantet, veglat – mjete prodhuese dhe impiantet transportuese të transportit të brendshëm dhe të jashtëm).</i>
Java e dhjetë	<i>Krijimi i raporteve për makinat përpunuese</i>
Java e njëmbëdhjetë	<i>Furnizimi me materiale i resorëve të ndryshëm.</i>
Java e dymbëdhjetë	<i>Njohja lidhur me mirëmbajtjen e stabilimenteve të makinave.</i>
Java e trembëdhjetë	<i>Njohja me njësinë e mbrojtjes Higjeno – Teknike.</i>
Java e katërbëdhjetë	<i>Njohja me proceset menaxheriale të udheheqjes së repartit prodhues.</i>
Java e pesëmbëdhjetë	<i>Prezantimi i Praktikës përfundimtare profesionale (Ditarit të praktikës)</i>
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
<i>Pjesëmarrja e rregullt e ligjëratave dhe ushtrimeve është e nevojshme, si dhe pjesëmarrja aktive me diskutimin dhe zgjidhjen e detyrave. Telefonat celularë duhen të fiken ose të vendosen në modalitet të heshtur.</i>	